



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR
DEPARTAMENTI I PROGRAMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT
DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

Nr. 3103, Prot

Tiranë, më 30 . 05 .2023

L ë n d a: *Dërgojmë, Raportin e monitorimit të buxhetit për periudhën janar - prill 2023,*

**MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË,
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT,
DREJTORISË SË ANALIZAVE DHE PROGRAMIMIT BUXHETOR,**

T I R A N Ë.

Në zbatim të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë bashkëlidhur po ju dergojmë, Raportin dhe anekset e monitorimeve të buxhetit për periudhën janar – prill 2023, për grupin buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Ju faleminderit për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

RUDIN BAQLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

DEPARTAMENTI I PROGRAMIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT
DREJTORIA E PROGRAMIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

RAPORTI

I

MONITORIMEVE PËR PERIUdhËN JANAR – PRILL 2023

Me ligjin nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti i shtetit për vitin 2023, pjesë e të cilit është edhe buxheti për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”. Fondet buxhetore të këtij grupi buxhetor, për vitin 2023, janë miratuar në tre programe buxhetore;

- Programi buxhetor 01110, “**Planifikim, Menaxhim dhe Administrim**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Programi buxhetor 01140, “**Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë”.
- Programi buxhetor 03310, “**Buxheti Gjyqësor**”, ku përfshihen fondet buxhetore, për funksionimin e veprimtarisë së gjykatave në të tre nivelet.

Qëllimi kryesor për programin “**Planifikim, menaxhim dhe administrim**” është “Përmirësimi i sistemit gjyqësor nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve që përbëjnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e burimeve dhe kapaciteteve financiare të nevojshme”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar objektivi: “KLGJ-ja do të angazhohet në vendosjen e standardeve të larta të kapaciteteve njerëzore dhe institucionale të saj si dhe për përmirësimin e performancës së gjyqësorit në të tre nivelet” me tregues performance:

1. Numri i akteve nënligjore të miratuara nga KLGJ-ja kundrejt totalit të vendimeve të marra, në masën 95%.
 2. Numri i vlerësimeve etiko-profesionale të magjistratëve në masën 69%.
- Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 3 produktet e mëposhtme:

Produkti 92901AA - “Vendime të miratuara”

Produkti M290072 - “Blerje Pajisje”

Produkti M290057 - “Rikonstruksion”.

Programi buxhetor “**Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë**” ka për qëllim: “Përcaktimin e prioriteteve, politikave dhe standardeve, në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë”.

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektiv “Angazhimi i QTI-së, për garantimin e arritjes së standardeve të BE-së për teknologjinë e informacionit dhe komunikimit” me tregues performance: Përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit në sistemin e drejtësisë në masën 50%.

Për realizimin e këtij treguesi është planifikuar 1 produkt për këtë program:

Produkti 92903AA - “Akte të miratuara”.

Qëllimi kryesor për programin “**Buxheti Gjyqësor**” është: “Ofrimi efikas i shërbimeve dhe punë më e mirë në gjykatat e 3 niveleve”

Për realizimin e këtij qëllimi është përcaktuar si objektiv; “Të përmirësohet ofrimi i shërbimeve përmes novacionit dhe forcimit të strukturave dhe sistemeve të teknologjisë, që zhvillojnë koherencën, efikasitetin dhe efektshmërinë institucionale”, me tregues performance:

1. Përmirësimi, ose ngritja e sistemeve të teknologjisë së informacionit, të cilat përmbushin standartet ndërkombëtare dhe rrisin efikasitetin në ofrimin e shërbimeve, sipas ritmeve të ndryshimeve të teknologjisë, në masën 78%.
2. Vlerësimi dhe përmirësimi i infrastrukturës gjyqësore (ndërtesa, mjedise pune), për të garantuar standarde bashkëkohore në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ofrimin dinjitoz të shërbimit për publikun, në masën 62%.

Për realizimin e këtyre treguesve janë përcaktuar 7 produktet e mëposhtme:

- 1- **Produkti: 92902AA** - “Çështje të gjykuara”
- 2- **Produkti M29066** - “Studime dhe projektme:
- 3- **Produkti: M290068** - “Ndërtim i ri dhe rikonstruksion i plotë”
- 4- **Produkti: 21AC501** - “Blerje softwarë për gjykatat
- 5- **Produkti: 18AD801** - “Blerje orendi dhe pajisje zyre”
- 6- **Produkti: 21AC401** - “Blerje pajisje për infrastrukturën elektronike”
- 7- **Produkti: M290075** - “Blerje mjete motorike”

Objektivat e programeve janë të lidhura me produktet, mbi bazën e të cilave kryhet edhe raportimi vjetor i realizimit të tyre.

Në vijim jepen të dhëna për realizimin e fondeve buxhetore për pushtetin gjyqësor për 4-mujorin e parë të vitit 2023.

Aneksi nr.1 – Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve, për 4 mujorin e parë të vitit 2023.

Pasqyra e raportit të shpenzimeve sipas programeve

000/ lekë

Programi	Buxheti i fillimit të vitit 2023	Buxheti i rishikuar vjetor 2023	Buxheti i periudhës raportuese J-P, 2023	Realizimi i periudhës raportuese	% e realizimit
01110	324,700	325,900	197,700	75,068	38%
01140	12,900	13,000	10,300	909	9%
03310	4,025,000	4,028,200	2,836,050	945,302	33%
Totali	4,362,600	4,367,100	3,044,050	1,021,279	34%

Buxheti i miratuar me ligjin 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, për të tre programet buxhetore në fillim të vitit ishte në shumën **4,362,600 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën **324,700 mijë lekë**.
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën **12,900 mijë lekë**.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në shumën **4,025,000 mijë lekë**.

Gjatë periudhës raportuese janar-prill 2023, buxhetit i grupit buxhetor është rishikuar si më poshtë:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me Udhëzimin Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, ka miratuar çeljen e fondit të veçantë për grupin buxhetor Këshillin e Lartë Gjyqësor në shumën **4,500 mijë lekë**. KLGJ me shkresën nr. 1359, datë 16.02.2023, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka kërkuar detajimin e këtij fondi në:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën **1,200 mijë lekë**.
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë”, në shumën **100 mijë lekë**.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor”, në shumën **3,200 mijë lekë**.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023, ka miratuar këtë detajim.

Buxheti i rishikuar vjetor për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, pas ndyshimit të mësipërme është në shumën **4,367,100 mijë lekë** i ndarë përkatësisht:

- Programi 01110 - “Planifikim, menaxhim dhe administrim” në shumën **325,900 mijë lekë**,
- Programi 01140 - “Mbështetje për Teknologjinë e Sistemit të Drejtësisë” në shumën **13,000 mijë lekë**.
- Programi 03310 - “Buxheti Gjyqësor” në shumën **4,028,200 mijë lekë**.

Për periudhën janar-prill 2023 për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, buxheti i planifikuar është në shumën **3,044,050 mijë lekë**, ndërsa realizimi është në shumën **1,021,279**

mijë lekë ose në masën **34%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Realizimi në këtë masë është i lidhur me mosrealizimin e fondit në shpenzime kapitale për shkak të çeljes me vonesë të fondeve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, vijimin e procedurave të prokurimeve të fondeve në shpenzime operative, por edhe vakancave të shumta në sistemin gjyqësor. Numri i punonjësve të Sistemit Gjyqësor i miratuar me ligj për vitin 2023, është **1,759 vetë**, nga këto; **128 vetë** janë punonjës të stafit të KLGJ-së, **6 vetë** është numri i punonjësve të QTI-së dhe **1,625 vetë** është organika e stafit gjyqësor. Numri faktik për periudhën janar- prill 2023 për sistemin gjyqësor është **1,443 vetë**, ndërsa mungesat janë **316 vetë** si në pasqyrën më poshtë;

Pasqyra e organikës së sistemit të drejtësisë(KLGJ/QTI /Gjykatat)

<i>Emërtimi</i>	<i>Struktura organizative e miratuar me ligj për vitin 2023</i>	<i>Struktura faktike në fund të muajit prill 2023</i>	<i>Diferenca</i>
KLJGJ	128	107	21
QTI	6	1	5
Gjykatat	1,625	1,335	290
Totali	1,759	1,443	316

Numri i punonjësve të KLGJ-së, i miratuar me ligj është **128** punonjës ndërsa aktualisht janë **101** punonjës, pra ka një mungesë me **27** punonjës, si dhe **5** punonjës të QTI-së që mungojnë, nga 6 punonjës të planifikuar.

Për vitin 2023. numri i miratuar me ligj për progrmin “Buxheti Gjyqësor”, është **1,625 punonjës** nga këto; 408 janë magjistratë dhe 1,217 janë punonjës të administratës gjyqësore, ndërsa faktikisht në fund të muajit prill në strukturat organike të gjykatave rezultojnë **1,335 punonjës** (303 magjistratë dhe 1,032 janë punonjës të administratës).

Aktualisht në gjykata ka mungesa në strukturën organike me **290** punonjës; nga të cilët **105** janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe **185** janë punonjës të administratës. Ndërkohë nga **303** magjistratë, që rezultojnë në shtrukturën organike, efektivish në detyrë janë **220** magjistratë, pasi **83** prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75% të pagës.

Përveç fondeve buxhetore, gjykatat në zbatim të V.K.M nr. 432, datë 08.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave detyësore që krijojnë institucionet buxhetore”, si dhe Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë të Drejtësisë nr. 33 datë 29.12.2014 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për veprime e shërbime të administratës gjyqësore”, kanë përdorur edhe një pjesë të të ardhurave të krijuara prej tyre. Për periudhën raportuese, realizimi i shpenzimeve nga të ardhurat jashtë limitit (vetëm për programin 03310 - Buxheti Gjyqësor) është në shumën **686 mijë lekë** (të rakorduara edhe me sistemin

Në mënyrë më të detajuar të dhënat për të 3 programet paraqiten në aneksin nr.2.


Aneksi nr.2 -Raporti i shpenzimeve të programeve, sipas artikujve për periudhën janar-prill të vitit 2023.

Pasqyra e fondeve buxhetore për sistemin gjyqësor të detajuara sipas artikujve

000/lekë

Art.	Emërtimi	Plan Fillestar viti 2023	Plan i Rishikuar Viti 2023	Plani i Periudhës 4/mujore progresive 2023	Fakti i Periudhës 4/mujore progresive 2023	% e realizimit /planit të periudhes raportuese
1	2	3	4	5	6	7=6/5
600	Paga	2,619,550	2,619,550	1,574,000	779,163	50%
601	Sigurime Shoqërore	319,150	319,150	176,650	91,072	52%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	683,376	683,376	548,376	149,287	27%
606	Trans për Buxh. Fam. & Individ	9,524	14,024	14,024	1,213	9%
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	3,631,600	3,636,100	2,313,050	1,020,919	44%
230	Kapitale të Patrupëzuara	58,600	58,600	58,600	0	0%
231	Kapitale të Trupëzuara	672,400	672,400	672,400	360	0.05%
Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit					686	
Totali		4,362,600	4,367,100	3,044,050	1,021,965	34%

I shprehur në formë grafike detajimi i fondeve buxhetore për vitin 2023 për çdo artikull dhe realizimi i tyre për 4 mujorin e parë të viti paraqitet si më poshtë.



I-

II-Programi - 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim"

Programi - 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim"

000/lekë

Emërtimi	Buxheti i fillimit të vitit 2023	Buxheti i rishikuar vjetor 2023	Buxheti i periudhës raportuese	Realizimi janar-prill 2023	% e realizimit
----------	----------------------------------	---------------------------------	--------------------------------	----------------------------	----------------

Shpenzime korrente	309,700	310,900	182,700	75,068	41%
Shpenzime kapitale	15,000	15,000	15,000	0	0%
Totali	324,700	325,900	197,700	75,068	38%

Buxheti i alokuar me ligjin e buxhetit për Këshillin e Lartë Gjyqësor në këtë program, në fillim të vitit 2023 ishte në shumën **324,700 mijë lekë**, i detajuar përkatësisht në shumën **309,700 mijë lekë** në shpenzime korrente dhe në shumën **15,000 mijë lekë** në investime.

Gjatë periudhës janar- prill 2023, buxheti në këtë program është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **1,200 mijë lekë** miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023.

Buxheti i rishikuar vjetor në këtë program si rezultat i alokimit të fondit të veçantë është në shumën **325,900 mijë lekë**, ndërsa buxheti për periudhën raportuese, është në shumën **197,700 mijë lekë**, nga të cilat në shumën **182,700 mijë lekë** për shpenzime korrente dhe në shumën **15,000 mijë lekë** në investime.

Realizimi faktik për periudhën raportuese është në shumën **75,068 mijë lekë** ose në masën **38%** të buxhetit të rishikuar të periudhës raportuese, ose në masën **23%** kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

“**Artikulli 600 + 601**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime personeli*” për këtë program është në shumën **236,500 mijë lekë**, ndërsa për periudhën raportuese buxheti i detajuar është në shumën **115,000 mijë lekë** dhe realizimi faktik i tij është në shumën **63,699 mijë lekë** ose në masën **55%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Numri i punonjësve të KLGJ-së i miratuar me ligj për vitin 2023 është **128** punonjës ndërsa aktualisht në fund të muajit prill në organikën faktike të KLGJ-së, rezultojnë **107** punonjës pra ka një mungesë me **21** punonjës, e cila ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“**Artikulli 602**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program është në shumën **71,700 mijë lekë**, ndërsa për periudhën raportuese plani është në shumën **65,000 mijë lekë** dhe realizimi faktik është në shumën **11,185 mijë lekë** ose në masën **17%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Fondi ka shërbyer për plotësimin e nevojave të stafit të KLGJ-së me materiale e shërbime zyre, shpenzime për udhëtim e dieta si dhe janë kryer likuidimet e shpenzimeve të shërbimeve ndaj të tretëve për drita ujë energji elektrike etj. Ndërkohë gjatë 4 muajit të parë të këtij viti për nevojat e stafit të KLGJ-së, janë lidhur kontratat vjetore me objekt; " Shërbim printimi dhe fotokopjimi", "Shërbim larje automjetesh", "Shërbim mirëmbajtje automjetesh", "Pjesë këmbimi, goma, bateri për automjetet", "Shërbim mirëmbajtje paisje audio - Salle plenare", "Karburant", vlera e të cilave po likuidohet gradualisht gjatë vitit, në përputhje me kushtet kontraktuale. KLGJ-ja vazhdon procedurat e prokurimit.

“**Artikulli 606**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individë*” për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2023, u detajua fondi në shumën **1,500 mijë lekë**, ti cili do të përdoret kryesisht për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarve publikë” i ndryshuar. Fondit të detajuar në fillim të viti në këtë artikull sikurse cituam më sipër ju shtua fondi i

veçantë në shumën **1,200 mijë lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023.

Buxheti i rishikuar në këtë artikull është në shumën **2,700 mijë lekë**. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit është përdorur për pagesat sipas limitit të shërbimeve telefonike për nevojat e punonjësve të stafit të KLGJ-së, fondi në shumën **184 mijë lekë**.

Realizimi i fondeve në shpenzime korrente është e lidhur me realizimin e produktit kryesor të këtij programi: **Produkti 92901AA** - “Vendime të miratuara”. Në fillim të vitit mbështetur në politikën e programit, objektivat dhe stafin, u planifikuan rreth **600** vendime. Për 4 mujorin e parë janë miratuar rreth 221 të tilla, ose 37% e numrit të planifikuar vjetor të vendimeve, ndërsa në se i referohemi një plani 4 mujor ($600/3=200$), kemi një realizim mbi 100%.

“**Artikulli 231**” - Buxheti vjetor për shpenzime kapitale, në këtë program, është në shumën **15,000 mijë lekë**, i detajuar në dy produkte:

- **Produkti M290072** (Blerje pajisje) në shumën **14,500 mijë lekë**, i cili do të përdoret për plotësimin e nevojave të KLGJ-së me “Pajisje audio vizuale; “Pajisje të tjera teknike”; “Pajisje kompjuterike”, “Pajisje të tjera zyre”.

- **Produkti M290057 “Rikonstruksion”** fondet janë detajuar në shumën **500 mijë lekë**, të cilat do të përdoren për nevojat e identifikuara për rikonstruksion të ambjenteve të godinës së KLGJ-së dhe përshtatjen e një zyre për Sektorin e Protokoll Arkivës.

Fondi në investime nuk është realizuar pasi nga MFE-ja, ky fond është bërë i disponueshëm vetëm në fund të muajit prill 2023, sikurse jemi vënë në dijeni nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë më shkresën nr 5647/1 datë 18.04.2023 dhe me shkresën 5447/2 datë 02.05.2023.

III- Programi - 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”

Programi - 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”

000/lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Buxheti i fillimit të vitit 2023</i>	<i>Buxheti i rishikuar vjetor 2023</i>	<i>Buxheti i periudhës raportuese</i>	<i>Realizimi janar-prill 2023</i>	<i>% e realizimit</i>
Shpenzime korrente	12,900	13,000	10,300	909	9%
Totali	12,900	13,000	10,300	909	9%

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 972, datë 02.12.2020 “Për organizimin, funksionimin e përcaktimin e kompetencave të Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë” pika 4 citon se, “Qendra financohet nga buxheti i shtetit si një program buxhetor i veçantë në buxhetin e përgjithshëm të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Fondi i akorduar në fillim të vitit si pjesë përbërëse e grupit buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor”, për këtë program është në shumën **12,900 mijë lekë**. Gjatë periudhës janar- prill 2023, buxheti në këtë program është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **100 mijë lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë program është në shumën **13,000 mijë lekë**, ndërsa buxheti i periudhës raportuese është në shumën **10,300 mijë lekë**. Realizimi

faktik për periudhën raportuese është në shumën **909 mijë lekë** ose në masën 9% kundrejt buxhetit të periudhës raportuese, ose në masën 7% kundrejt buxhetit të rishikuar vjetor (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

“**Artikulli 600 + 601**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime personeli*”, për këtë program është në shumën **12,500 mijë lekë** ndërsa për periudhën raportuese buxheti është në shumën **9,800 mijë lekë** dhe realizimi faktik i tij është në shumën **686 mijë lekë** ose në masën 7 % (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Numri i punonjësve të QTI-së i miratuar me ligj për vitin 2023, është 6 punonjës, ndërsa aktualisht është punësuar vetëm 1 punonjës (Drejtori i QTI-së), pra ka një mungesë me 5 punonjës, e cila ka ndikuar në masën e realizimit të këtij artikulli.

“**Artikulli 602**” - Buxheti vjetor i alokuar në “*Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera*” për këtë program është në shumën **376 mijë lekë**. Fondi është realizuar në shumën **223 mijë lekë** ose në masën **59%** të rakorduar edhe me sistemin SIFQ. Fondi është përdorur për kryerjen e shpenzimeve për pagesa “Honorare Bordi”, për 15 anëtarët e Bordit Drejtues të QTI-së.

“**Artikulli 606**” - Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në “*Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë*” në shumën **24 mijë lekë**, do të përdoret kryesisht për pagesa të shpenzimeve të telefonisë celulare. Fondi është rishikuar si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **100 mijë lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02. 2023. Gjatë 4 mujorit të parë të vitit ky fond nuk është përdorur.

Fondet në shpenzime korrente të detajuara në këtë program janë në funksion të produktit të vetëm të këtij programi që, është “Akte të miratuara”. Për vitin 2023, në **Produktin-92903AA “Akte të miratuara”**, janë planifikuar të miratohen nga Bordi Drejtues i qendrës reth 20 akte. Gjatë 4- mujorit të parë të viti janë miratuar 3 akte. Produkti është realizuar në masën 15% kundrejt planifikimit vjetor, ndërsa nëse i referohemi një plani 4 mujor ($20/3=6.6$ akte) është në masën 45%.

III - Programi - 03310 “Buxheti Gjyqësor”

Programi - 03310 “Buxheti Gjyqësor”

000/lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Buxheti i fillimit të vitit 2023</i>	<i>Buxheti i rishikuar vjetor 2023</i>	<i>Buxheti i periudhës raportuese</i>	<i>Realizimi janar-prill 2023</i>	<i>% e realizimit</i>
Shpenzime korrente	3,309,000	3,312,200	2,120,050	944,942	45%
Investime	716,000	716,000	716,000	360	0.05%
Totali	4,025,000	4,028,200	2,836,050	945,302	33%

Fondi i akorduar për këtë program në fillim të vitit 2023, në shumën **4,025,000 mijë lekë**, u rishikua si rezultat i akordimit të fondit të veçantë në shumën **3,200 mijë lekë** miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02.2023.

Buxheti i rishikuar vjetor është në shumën **4,028,200 mijë lekë**, ndërsa realizimi faktitk është në shumën **945,302 mijë lekë**, ose në masën **23,4%** të tij. Buxheti i periudhës raportuese janar-prill është në shumën **2,836,050 mijë lekë**, i ndarë përkatësisht; në shumën **2,120,050 mijë lekë** në shpenzime korrente dhe në shumën **716,000 mijë lekë** në shpenzime kapitale.

Realizimi faktik i fondeve buxhetore për periudhën raportuese janar-prill, është në shumën **945,302 mijë lekë**, ose në masën **33%** të tij (të rakorduara edhe me SIFQ).

Në mënyrë të detajuar për çdo artikull situata paraqitet si më poshtë:

“Artikulli 600 + 601” - Në *“Shpenzime personeli”*, buxheti vjetor i alokuar për këtë program është në shumën **2,689,700 mijë lekë**, ndërsa buxheti i periudhës raportuese është në shumën **1,625,850 mijë lekë**. Realizimi faktik në shpenzime personeli për periudhën raportuese është në shumën **805,851 mijë lekë**, ose në masën **50%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Realizimi në këtë masë është i lidhur me mungesat në sistemin gjyqësor;

Për vitin 2023. numri i miratuar me ligj për progrmin *“Buxheti Gjyqësor”*, është **1,625 punonjës** nga këto; 408 janë magjistratë dhe 1,217 janë punonjës të administratës gjyqësore, ndërsa faktikisht në fund të muajit prill në strukturat organike të gjykatave rezultojnë **1,335 punonjës** (303 magjistratë dhe 1,032 janë punonjës të administratës).

Aktualisht në gjykata ka mungesa në strukturën organike me **290 punonjës**; nga të cilët **105** janë gjyqtarë (vakanca të përhershme) dhe **185** janë punonjës të administratës. Ndërkohë nga **303** magjistratë, që rezultojnë në shtrukturën organike, efektivish në detyrë janë **220** magjistratë, pasi **83** prej tyre janë të pezulluar me vendim të KPK dhe paguhen me 75% të pagës.

Gjithashtu zbatimi i VKM nr. 495 *“Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”*, ka sjellë ndryshime në strukturat organizative të gjykatave që janë pjesë e këtij vendimi, të cilat do të kenë dhe efektin e tyre financiar. Për këtë arsye gjykatatave (pritëse) që mbeten mbas këtij riorganizimi për të mos i vënë në vështirësi në muajt e parë pas bashkimit ju është detajuar një fond më i madh, krahasuar me muajt e fundit të vitit.

“Artikulli 602” – Buxheti vjetor i alokuar për vitin 2023 në *“Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera”* është në shumën **611,300 mijë lekë**, ndërsa buxheti i periudhës raportuese në këtë artikull është në shumën **483,000 mijë lekë** dhe është realizuar në shumën është në shumën **137,878 mijë lekë**, ose në masën **29%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ). Gjykatat gjatë kësaj periudhe, kanë shlyer detyrimet mujore për shërbime si energji elektrike, ujë, telefon, postë dhe shërbimin korrier. Janë likuiduar shpenzime transporti, shpenzime mirëmbajtje të zakonshme, shpenzime për udhëtim e dieta, shpenzime të tjera speciale etj. Gjithashtu pjesë e fondeve buxhetore të artikullit 602 *“Shpenzime operative”* janë dhe fondet e detajuara në programin 03310 të KLGJ –së në shumën 308,764 mijë lekë të cilat do të administrohet nga KLGJ për nevojat e gjykatave. Gjatë 4 mujorit të parë janë lidhur kontratat dhe ka filluar realizimi i kontratave vjetore me objekt; *“Shërbime të sigurimit dhe ruajtjes në gjykata”*, *“Shërbime mirëmbajtje të sistemit audio-video në gjykata RDA dhe Backup Chain”*, *“Shërbim interneti dhe intraneti për KLGJ-në dhe gjykatat”*, *“Shërbim mirëmbajtje e programit financiar”*, *“Mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe infrastrukturës mbështetëse në gjykata”*, *“Liçensa, mirëmbajtje dhe zhvillim për programet M Files dhe SDM*

Lot", likuidimi i të cilave bëhet në mënyrë pjesore gjatë vitit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në kontratë. Gjykatat dhe KLGJ-ja vazhdojnë procedurat e prokurimit.

“Artikulli 606” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Transferta për Buxhete Familjare dhe Individë”* i detajuar me ligjin e buxhetit në këtë program ishte në shumën **8,000 mijë lekë**. Fondi do të përdoret kryesisht për kryerjen e kompesimeve të shpenzimeve të telefonisë celulare, pagesat për gjyqtarët në skemë delegimi si dhe lidhur me përfitimin interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllime banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore.

Fondi i akorduar në këtë artikull u rishikua në shumën **3,200 mijë lekë**, miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3444/1, datë 24.02. 2023. Buxheti i rishikuar vjetor në këtë artikull është në shumën **11,200 mijë lekë**, ndërsa realizimi për 4 mujorin e parë i këtij fondi është në shumën **1,213 mijë lekë**, ose në masën **11%** (të rakorduara edhe me sistemin SIFQ).

Realizimi i fondit në shpenzime korrente është i lidhur me realizimin e **Produktit nr. 1 - 92902AA “Çështje të gjykuara”**. Për vitin 2023 janë parashikuar të realizohen **143,180 çështje**. Parashikimi i numrit të çështjeve nga ana e gjykatave është kryer referuar tendencës së numrit të çështjeve për disa vite si edhe në përputhje me situatën specifike në Sistemin Gjyqësor. Nga informacioni i marrë nga gjykatat gjatë 4-mujorin e parë të vitit janë realizuar **40,908 çështje**. Referuar planit vjetor realizimi i këtij produkti është rreth **28.5 %**, kurse kundrejt planit 4 mujor ($143,180/3 = 47,726.6$) është rreth **85.7%**.

“Artikulli 230+231” Buxheti në shpenzime kapitale për programin 03310 për vitin 2023 është i detajuar, në *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”* Artikullin 230 në shumën **58,600 mijë lekë** dhe në *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”* Artikulli 231 në shumën **657,400 mijë lekë**.

“Artikulli 230” - Buxheti vjetor i alokuar në *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”*, në shumën **58,600 mijë lekë**, i detajuar vetëm për 1 produkt.

Produkti nr. 2 - M290066 “Sudime dhe projekte”, fondi në shumën **58,600 mijë lekë** i detajuar në programin 03310 të KLGJ do të shërbejë për hartimin e 4 projekteve të zbatimit për: Gjykatën e Lartë në shumën **30,000 mijë lekë**; Gjykatën e Apelit Tiranë në shumën **20,000 mijë lekë** dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në shumën **8,000 mijë lekë**. Ndërsa pjesa tjetër e fondit në shumën **600 mijë lekë** është detajuar për projektin e rikonstruksionit të dhomës së serverit për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Produkti nuk është realizuar, pasi fondi në investime deri në fund të muajit prill, për grupin buxhetor *“Këshilli i Lartë Gjyqësor”*, ka qënë i pa çelur nga MFE.

“Artikulli 231” - Buxheti vjetor i alokuar në fillim të vitit në *“Shpenzime kapitale të trupëzuara”*, për këtë program është në shumën **657,400 mijë lekë** i detajuar në 5 produkte si më poshtë;

Produkti nr. 3 - M290068 - “Ndërtim i ri dhe Rikonstruksion i plotë/pjesshëm”, janë alokuar fondet në shumën **56,500 mijë lekë**; nga të cilat për nevojat e 8 gjykatave është detajuar fondi në shumën **52,950 mijë lekë**, ndërsa diferenca e fondit në shumën **3,550 mijë lekë**. i cili do të administrohet nga KLGJ-ja programi 03310, është menduar të përdoret për kryerjen e punimeve në nivel mirëmbajtje të godinave të 12 gjykatave të tjera.

Produkti nr. 4 - 21AC501- “Programe Software për gjykatat”, është detajuar fondi në shumën **361,800 mijë lekë**, i cili është parashikuar të përdoret për realizimin e 10 projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit, në sistemin gjyqësor, si më poshtë:

- *Projekti për digjitalizimin e dosjeve të arkivit gjyqësor*, për vitin 2023 janë detajuar në shumën **38,600 mijë lekë**
- *Projekti për zhvillimin i një aplikacioni web për regjistrin elektronik të urdhërit mbrojtjes*, për vitin 2023 janë detajuar fonde në shumën **3,000 mijë lekë**,
- *Projekti për zhvillimin e një sistemi të ri të menaxhimit të çështjeve gjyqësore*, për vitin 2023 janë detajuar fonde në shumën **212,000 mijë lekë**.
- *Blerje pajisje software, instalim dhe zhvillime të reja në sistemin ICMIS*, janë detajuar fondet në shumën **30,500 mijë lekë**.
- *Projekti aplikacioni për avokatët, i dizenuar të përdoret për sisteme operimi i OS, Android për Smart Phone*, janë detajuar fonde në shumën **2,400 mijë lekë**.
- *Projekti e-inspektori, për t'i mundësuar akses Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, akses në sistemin e menaxhimit të çështjeve gjyqësore*, janë detajuar fonde në shumën **28,800 mijë lekë**.
- *Projekti i nënshkrimit elektronik dhe të pagesave online*, janë detajuar fonde në shumën **31,600 mijë lekë**.
- Gjithashtu, fondi në shumën **14,900 mijë lekë**, është detajuar për 3 projekte në vazhdim nga viti 2022 dhe të shtrira pjesërisht gjatë vitit 2023, si projekti Disaster recovery, projekti Regjistri elektronik kombëtar OJF dhe projekti Infrastruktura mbështetëse për hostimin e sistemit të ri ICMIS.

Produkti nr. 5 - 18AD801 “Blerje orendi e pajisje zyre” për vitin 2023 janë detajuar fonde në shumën **189,100 mijë lekë**. Fondi në shumën **16,000 mijë lekë** është detajuar për nevojat e 13 (trembëdhjetë) gjykatave, ndërsa fondi në shumën **173,100 mijë lekë**, i cili do të administrohet nga KLGJ, është detajuar për *Projektin e sigurisë për gjykatat*, me kosto totale e këtij projekti në shumën 446,400 mijë lekë. Ky sistem ka për qëllim pajisjen e 20 gjykatave (13 prej tyre janë gjykatat e përmendura më sipër të cilat kanë fond të detajuar edhe më vete sikurse u citua më sipër) me mjete teknologjike të cilat mundësojnë monitorimin e çështjeve të sigurisë në gjykata.

Produkti nr. 6 - 21AC401 “Blerje pajisje për infrastrukturën elektronike”, janë detajuar fonde për vitin 2023 në shumën **20,000 mijë lekë**.

Ky fond do të administrohet nga KLGJ-ja dhe do të përdoren për plotësimin e nevojave në infrastrukturën elektronike (si server, switch, kompjuter, UPS serveri, UPS kompjuteri, printer, sisteme fonie, skaner, fotokopje, diktofon, harddisk, monitor) të 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjykatave.

Produkti nr. 7 - M290075 “Blerje mjete motorike”, janë detajuar fonde për vitin 2023 në shumën **30,000 mijë lekë**, të parashikuara të përdoren për blerjen e 10 copë automjete, për përmirësimin dhe rinovimin e mjeteve të transportit në sistemin gjyqësor dhe do të administrohet nga KLGJ programi 3310.

Fondi i planifikuar në investime (Art 230+231), në këtë program, në shumën **716,000 mijë lekë**, është realizuar vetëm pjesërisht në shumën **360 mijë lekë**, ose në masën **0,05%** (të rakorduar edhe me sistemin SIFQ), në produktin **18AD801** “Blerje paisje zyre”.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë më shkresën nr 5647/1 datë 18.04.2023 dhe me shkresën 5447/2 datë 02.05.2023, ka përcjellë miratimin e detajimit të fondeve në investime, kjo ka sjellë pamundësinë e përdorimit të këtij fondi për 4 mujorin e parë të vitit nga gjykatat.

Gjykatat janë duke përgatitur dokumentacionin për të filluar procedurat e prokurimeve. Në muajt në vijim do kemi një përmirësim të performancës së gjykatave dhe rritje të koeficientit të realizimit të fondeve buxhetore.

Për periudhën janar-prill 2023, gjykatat kanë realizuar shpenzime edhe nga të ardhurat e krijuara prej tyre. Në total janë kryer në shumën **868 mijë lekë** shpenzime nga të ardhurat, nga të cilat në shumën **446 mijë lekë** në shpenzime operative dhe në shumën **240 mijë lekë** në investime.


Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programeve raportohet në fund të vitit, pasi treguesit që analizojnë ANEKSI nr. 3 "Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës/produkteve të programit" dhe ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit" përcaktohen qartë vetëm në nivel realizimi vjetor dhe jo 4- mujor. Për këtë arsye, në pjesën narrative të raportit nuk po jepen shpjegime, por të dhënat për realizimin faktik të produkteve për periudhën raportuese janë të pasqyruara në anekset, bashkëlidhur raportit.

Aneksi nr. 5- Raporti i projekteve me financim të brendshëm për periudhën janar- prill të vitit 2023

Detajimi i fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2023, në shpenzime kapitale (investime) sipas grupeve të investimeve dhe kodit të projektit, u krye duke mbajtur në vëmendje; nevojat e shpenzimeve për programe softwarë, si dhe nevojat e përvitshme për pajisje elektronike, (të cilat garantojnë funksionimin normal dhe mënjanojnë riskun e ndërprerjes së funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore), nevojat për pajisje zyre, kryesisht zëvendësimin e atyre të amortizuara dhe nevojat shtesë të lindura, plotësimin e nevojave për pajisje sigurie, plotësimin e nevojave për rikonstruksionet e pjesshme sipas kërkesave të gjykatave.

Fondi i akorduar për vitin 2023 në shpenzime kapitale, për grupin buxhetor “Këshilli i Lartë Gjyqësor” është në total në shumën **731,000 mijë lekë**. Nga të cilat në shumën **15,000 mijë lekë** , ose 2% e fondit të investimeve në programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim” dhe në shumën **716,000 mijë lekë** ose 98% e fondit të investimeve në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, e shprehur në mënyrë grafike si më poshtë.

Pasqyara grafike e detajimit të fondeve buxhetore në investime sipas programeve




I - Programi - 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

Pasqyra- Detajimi i fondeve buxhetore, sipas grupeve investimeve dhe kodit të projektit për programin 01110 “Planifikim, menaxhim dhe administrim”

000 lekë

Kodi i projektit	Projekti	Buxheti i vjetor 2023	Realizimi i fondeve për-mujorin e parë 2023	% e realizimit vjetor
M290057	Rikonstruksion	500	0	0
M290072	Blerje pajisje	14,500	0	0
	Totali	15,000	0	0

Në formë grafike detajimi i fondeve sipas projektev paraqitet si më poshtë:



Për programin 01110- “Planifikim, menaxhim dhe administrim” për vitin 2022 janë planifikuar të realizohen 2 projekte në shumën totale **15,000 mijë lekë**, i detajuar si më poshtë:

1- Projekti M290057 “Rikonstruksion” fondet janë detajuar në shumën **500 mijë lekë**, të cilat janë parashikuar të përdoren për nevojat e identifikuar për rikonstruksion të ambienteve të godinës së KLGJ dhe përshtatje e një zyre për Sektorin e Protokoll Arkivës.

2- Projekti M290072 Blerje Pajisje fondet janë detajuar në shumën **14,500 mijë lekë** të cilat janë parashikuar të përdoren;

- Në “Pajisje audio vizuale”, kryesisht për nevojat e identifikuar dhe të programuara nga Sektori IT, në kuadër të implementimit të hartës së re gjyqësore, për blerje pajisje për sistemin e qendëruar në KLGJ për videokonferenca në gjykata. Mundësimi i blerjes së këtyre pajisjeve do të përmirësojë aksesin në drejtësi, duke ofruar mjete e pajisje të një cilësie të lartë të TI-së, për komunikim e video konferenca në gjykata.

- Në “Pajisje të tjera teknike” kryesisht për blerje pajisje për sallë trajnimesh dhe përkthimi simultan, ku përfshihen monitorë interaktiv, mikrofona, kabinë përkthimi, etj.

- Në “Pajisje kompjuterike”, kryesisht për blerje pajisje kompjuterike, si dhe SAN SWITCH, i cili do lidhë serverat me storage, Kompjuter Desktop 1, etj. Gjithashtu, parashikohet për blerje aksesorë Switch Layer 2, i cili kombinon funksionalitetin e një switch-i dhe një ruteri, që do të shërbejnë si ndërlidhës për pajisjet që janë në të njëjtin rrjet ose LAN virtual, me një shpejtësi shumë të lartë dhe ka inteligjencë të integruar.

- Në “Pajisje të tjera zyre”, kryesisht për nevojat e kërkesat e identifikuar nga Sektori i Shërbimeve Administrative, për blerje pajisje të ndryshme zyre.

Fondi nuk është realizuar pasi nga MFE fondi në investime është çelur në muajin prill sikurse jemi vënë në dijeni me shkresën e saj nr. 5647/1, datë 18.04.2023. dhe me shkresën 5447/2 datë 02.05.2023.

II - Programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”


Për programin 03310 “Buxheti Gjyqësor” për vitin 2023 janë planifikuar të realizohen 6 projekte, në shumën totale **716,000 mijë lekë**, të detajuara si në pasqyrën më poshtë:

Pasqyra - detajimi i fondeve buxhetore në investime për programin 03310, sipas kodit të projektit dhe realizimit faktik

000 lekë

Kodi i projektit	Emërtimi i projektit	Buxheti i për vitin 2023	Realizimi i fondeve për 4-mujorin e parë 2023	% e realizimit
M290066	Studime dhe Projektme	58,600	0	0%
21AC501	Programe Softëare për gjykatat	361,800	0	0%
M290068	Ndërtim i ri dhe Rikonstruksion i plotë/ pjesëshëm,	56,500	0	0%
21AC401	Blerje pajisje elektronike,	20,000	0	0%
18AD801	Blerje orendi e pajisje zyre	189,100	360	0,2%
M290075	Blerje mjete motorike	30,000	0	0%
	Totali	716,000	360	0,05%

Në formë grafike detajimi i fondeve sipas projektev paraqitet si më poshtë:



1- Projekti M290066 “Studime dhe Projektme”, për vitin 2022, vlera e fondit është në shumën **58,600 mijë lekë**.

